



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Programi për Ndërmarrës të Rinj

shpall ftesën e dytë për dorëzimin e aplikacioneve për grante

MUNDËSI BIZNESI

PËR
NDËRMARRËSIT
E RINJ

Give Life
to Your
Idea!

Jepi jetë
idesë
tënde!

Oživi
svoju
ideju!

APLIKO ONLINE

www.usaidyep.org

Programi për Ndërmarrës të Rinj inkurajon gratë, minoritetet dhe personat me nevoja të veçanta që të aplikojnë

Programi për Ndërmarrësit e Rinj

shpall ftesën e dytë për dorëzimin e aplikacioneve për grante
më datën 12 shtator 2011

PROGRAMI

Qëllimi i Programit për Ndërmarrësit e Rinj, i zbatuar nga Education Development Center, Inc. (EDC), është të përkrahen ndërmarrësit e rinj të zhvillojnë biznese të reja duke inkurajuar shpirtin e tyre novator dhe të ndërmarrësisë përmes ndihmës financiare dhe teknike. Në të njëjtën kohë programi ofron përkrahje të vazhdueshme dhe ndihmon në krijimin e rrjetit për ndërmarrësit e ardhshëm në Kosovë, të cilët janë të përgatitur të marrin parasysh rreziqet dhe kënaqësinë që vjen nga fillimi i një biznesi të ri.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të gjithë ndërmarrësit e moshës 18-35 vjeçare të cilët kanë të gatshme ndonjë ide për biznes dhe të cilët:

- Kanë përfunduar trajnimin për ndërmarrësi dhe kanë hartuar plane biznesi përmes përkrahjes nga programet tjera për ndërmarrësi, dhe/ose
- Posedojnë biznes jo më të vjetër se 24 muaj

SITË APLIKONI?

- Hapi 1: Vizitoni www.usaidyep.org
- Hapi 2: Klikoni butonin “**Apliko Online**”
- Hapi 3: Kliko butonin “**Apliko Këtu**”, për të filluar me plotësimin e aplikacionit

*Për udhëzime se si duhet aplikuar, ju lutem klikoni butonin “**Si të Aplikoni**”
Për më shumë informata rreth programit, ju lutem klikoni butonin
“**Udhëzuesi për Fondin Fillestar për Ndërmarrës**”*

Nëse keni probleme në lidhje me plotësimin e aplikacionit apo keni ndonjë pyetje rreth përmbushjes së kriterëve minimale, ju lutem të dërgoni një email me titull “Kërkesë për Ndihmë” në adresën: seedfund@usaidyep.org

Kjo shpallje do të jetë e hapur deri në njoftimin e radhës!

PROCESI I PËRZGJEDHJES

- 1) Stafi i Programit për Ndërmarrësit e Rinj do të shqyrtojë aplikacionet duke u bazuar në disa kritere të qarta:
 - mosha 18-35
 - përfundimi i trajnimit për ndërmarrësi, dhe/ose
 - posedimi i një biznesi jo më të vjetër se 24 muaj
- 2) Kandidatët që kalojnë fazën e parë të procesit të shqyrtimit do të ftohen për intervistë. Komisioni për shqyrtim do të vlerësojë aplikacionet dhe idetë afariste duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në “**Udhëzuesin për Fondin Fillestar për Ndërmarrës.**”
- 3) Kandidatët që kalojnë intervistën kualifikohen për të përfutur nga Programi për Ndërmarrësit e Rinj.

ÇFARË OFRON PROGRAMI PËR NDËRMARRËSIT E RINJ?

- Këshilla biznesi për të gjithë individët e kualifikuar për të përmirësuar planet e tyre të biznesit, në pajtim me kërkesat aktuale të tregut.
- Mbështetje për prezantimin e planeve të biznesit para Komisionit për Shqyrtimin e Planeve të Biznesit i cili është i përbërë nga institucionet financiare, stafi i programit dhe personat përkatës nga sektori i biznesit.
- Krijimin e lidhjeve me dhe referimi tek bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare.
- Grant fillestar deri në shumën prej 6,500 dollarë amerikan, në përputhje me fondet vetanake të ndërmarrësit, pasi të jetë pranuar plani i biznesit.
- Mbështetje të vazhdueshme për përfutjesit e grantit deri në 12 muaj, përmes këshillimit, mentorimit dhe përkrahjes teknike.



Education Development Center, Inc.

Give Life
to Your
Idea!

Jepi jetë
idesë
tënde!

Oživi
svoju
ideju!

“Kjo broshurë është realizuar me përkrahjen zemërgjerë të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmajtja është përgjegjësi e Education Development Center, Inc. (EDC) dhe nuk pasqyron domosdo pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.”

Për informata të mëtejshme, ju lutem kontaktoni:

Programin për Ndërmarrësit e Rinj

info@usaidyep.org

+381 38 742 318 / 319



www.facebook.com/usaidyep